



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 67

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

Prishtinë, më 26 mars 2013, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, dhe Gëzim Kelmendi.

Munguan: Sasha Gjokiq, Liburn Aliu, Salihe Mustafa dhe Flora Brovina.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj– koordinatore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i lartë i fushës për shëndetësi; Xheneta Sopjani-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Fikrim Damka- Tha se kemi një propozim nga deputetja Nazane Breca që të ndryshohet neni 8, dhe pas diskutimit grupi punues, propozon që të ndryshohet amendamenti 6, që ka të bëjë me nenin 8, dhe atë më këtë përmbajtje: *E drejta dhe përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pension kontributpagues të moshës për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna, ose të shpallur si tepricë teknologjike pa bazë ligjore, në vitet 1989 deri më 31 korrik 2002, do të rregullohet me akt ligjor, ose nënligjor të veçantë, deri më 1 korrik 2014.*

A pajtoheni me këtë ndryshim të propozuar nga grupi punues?

Komisioni miratoi amendamentin e propozuar nga grupi punues për Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Komisioni miratoi njëzëri amendamentet e propozuar për Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, dhe raporti me amendamente të procedohet te komisionet kryesore.

4. Të ndryshme

Time Kadriaj- Propozoj që në bazë të informatave nga institucionet shëndetësore rajonale, të kërkohet nga Ministria e Shëndetësisë informatë me shkrim se përse spitalet rajonale nuk janë të furnizuar me anestetik, të cilat janë barna të listës esenciale.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që të kërkon nga Ministria e Shëndetësisë, që në afat sa më të shkurtër të mundshëm, të njoftojë me shkrim Komisionin, rreth situatës së furnizimit të institucioneve shëndetësore me anestetik dhe barna të listës esenciale.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka